

LIGJ
Nr. 150/2014

PËR PENSIONET E PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA, NË NËNTOKË

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ligji ka për qëllim rregullimin e pensioneve të pleqërisë për punonjësit që kanë punuar në miniera, në nëntokë, me moshë, vjetërsi të përgjithshme dhe vjetërsi pune në profesion më të vogël se ato të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 2
Subjektet përfituese

Subjektet përfituese janë:

a) punonjësit, të cilët deri në datën 30.9.1993 kanë kryer procese pune në miniera, në nëntokë, sipas kritereve të përcaktuara në kreun I, të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punës në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar.

b) punonjësit, të cilët pas datës 30.9.1993 kanë kryer procese pune në miniera, në nëntokë, të dokumentuara sipas kritereve të përcaktuara në vendimin e mësipërm, pavarësisht nëse të punësuarit kanë kryer aktivitet ekonomik në subjekte private apo me kapital plotësisht ose pjesërisht shtetëror.

Neni 3
Kushtet e përfitimit

Kanë të drejtë të kërkojnë pension pleqërie si punonjës të minierave, në nëntokë, punonjësit, të cilët:

a) arrijnë moshën 55 vjeç;

b) kanë një periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë, nga të cilat jo më pak se 12 vjet e 6 muaj në procese pune në miniera, në nëntokë, me përjashtim të ish-punonjësve të nëntokës që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët do të përfitojnë pension sipas këtij ligji kur të arrijnë moshën 55 vjeç dhe të kenë një periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë, përfshirë këtu edhe periudhën e trajtimit të veçantë financiar, nga të cilat, jo më pak se 11 vjet e 6 muaj të jenë në procese pune në miniera, në nëntokë.

Neni 4
Masa e pensionit

Pensioni do të llogaritet sipas përcaktimeve të neneve 32 dhe 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 5

E drejta për përfitim

E drejta për të përfituar pensionin e pleqërisë, sipas këtij ligji, nuk parashkruhet.

Personi, i cili kërkon të përfitojë pension, sipas përcaktimeve të këtij ligji, e përfiton atë:

a) nga data e lindjes së të drejtës për përfitim, kur kërkesa paraqitet brenda një viti nga data e lindjes së kësaj të drejte;

b) nga data e paraqitjes së kërkesës, kur ajo paraqitet pas një viti pas lindjes së të drejtës për përfitimin e pensionit.

Personi, i cili ka përfituar pension sipas këtij ligji, nuk ka të drejtë përfitimi të kësteve për periudhën/periudhat, gjatë të cilave ushtron veprimtari ekonomike si i punësuar, i vetëpunësuar apo punëdhënës, me përjashtim kur vetëpunësohet në bujqësi.

Përfitimet e caktuara, por të patërhequra, paguhet në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet.

Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet.

E drejta e organit kompetent për të kërkuar shumat e marra tepër, gjatë një viti, ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit. Masa e ndalesës për çdo muaj është 20 për qind e kështit mujor të pensionit.

Personi, i cili ka përfituar pension dhe kompensime në mënyrë e me mjete në kundërshtim me ligjin dhe që nuk njofton ndryshimin ose heqjen e masës së tyre, detyrohet ta kthejë të gjithë shumën e marrë tepër. Masa e ndalesës për çdo muaj është 50 për qind e kështit mujor të pensionit. Gjithashtu, personi dënohet me gjobë në masën katërfish të dëmit të shkaktuar, pavarësisht nga dënimi i parashikuar në dispozitën përkatëse të Kodit Penal.

Neni 6

Financimi

Përfitimet nga ky ligj financohen nga kontributet shtesë, sipas paragrafit të dytë të këtij neni, dhe nga Buxheti i Shtetit.

Personat, të cilët do të kryejnë procese pune në miniera, në nëntokë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të paguajnë kontribute shtesë, në masën 5 për qind të pagës bruto, për efekt kontributi. Kontributi shtesë paguhet 3 për qind nga punëdhënësi dhe 2 për qind nga punëmarrësi.

Kontributi i sigurimeve shoqërore, në masën 5 për qind, mbledhet dhe derdhet në fondin e sigurimeve shoqërore të detyrueshme, sipas procedurave për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të përcaktuara në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Diferenca ndërmjet efektit financiar të këtij ligji, deri në plotësimin e moshës së përfituesve, sipas nenit 31, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me kontributin shtesë, do të përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Procedurat e financimit të fondit të sigurimeve shoqërore, sipas paragrafit të katërt të këtij neni, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Kërkesa për përfitim

Pensioni jepet me kërkesën e të interesuarit, i cili e paraqet atë së bashku me dokumentacionin përkatës, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pranë agjencisë së sigurimeve shoqërore të

vendbanimit të tij.

Neni 8
Kompensimet

Për pensionet me datë fillimi para datës 1.1.2015, masës së pensionit, sipas nenit 4 të këtij ligji, do t'i shtohen edhe kompensimet për çmimet dhe për të ardhurat që përfitohen në rastin e pensioneve të pleqërisë, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Përfitimet e caktuara sipas këtij ligji indeksohen me vendim të Këshillit të Ministrave sa herë dhe në atë masë që rriten ose indeksohen pensionet e pleqërisë, nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror.

Neni 9
E drejta për të zgjedhur përfitimin

Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar si punonjës të minierave të nëntokës, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", të ndryshuar, që plotësojnë kushtet e këtij ligji, kanë të drejtë të zgjedhin mes përfitimit që kanë dhe përfitimit që u lind nga ky ligj.

Neni 10
Llogaritja e pensionit

Llogaritja, caktimi, administrimi dhe pagimi i pensioneve që rrjedhin nga ky ligj bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas procedurave në fuqi për pensionet, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 11
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e neneve 6 dhe 8 të këtij ligji.

Neni 12
Dispozita të fundit

Ligji nr. 10 165, datë 15.10.2009, "Për caktimin e moshës së daljes në pension të punonjësve të nëntokës", shfuqizohet.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 6.11.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8811, datë 24.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**